

KONTRATË SHITBLERJE**“Kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë ORLU sh.p.k.”**

Sot më 13.10.2017, ne palët e mëposhtme me vullnetin e tonë të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, redaktuam këtë kontratë :

SHITËSI: **Liljana Thoma**, e bija e Josifit , e datëlindjes 19.09.1957, lindur në Toshkëz, Lushnje dhe banuese në Fier, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ID/pasaportën Nr. Personal I96023032U.

BLERËSI: **Kreshnik Seitaj**, i biri i Pajtim, i datëlindjes 10.07.1980, lindur në Peshkopi dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ID/pasaportën Nr. Personal I00710248V.

TË DHËNA PARAPRAKE:

- Shitësi, **Liljana Thoma** është ortak i vetëm i shoqërisë **“ORLU” Sh.p.k., me NUIS L52609403Q**, zotërues i 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë **“ORLU” Sh.p.k., me NUIS L52609403Q** e cila është një shoqëri tregtare shqiptare, regjistruar më datë 09/02/2015, me seli në Fier, Lagjja “Sheq i Vogël”, rruga “Leonardo Murialdo”, godinë 1 katëshe me Nr. 83.
- Ortaku i vetëm i shoqërisë **“ORLU” Sh.p.k., me NUIS L52609403Q**, me vendimin datë 12.10.2017, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Statutin e Shoqërisë, ka vendosur për transferimin nëpërmjet shitjes të 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të zotëruara prej tij, me vlerë 100000 (njëqind mijë) lekë, në favor të blerësit **Z. Kreshnik Seitaj**;
- Në kontratën e shitjes merr pjesë dhe jep pëlqimin e tij edhe bashkëshorti i shitësit, **Dhimiter Thoma**, i biri i Naunit , i datëlindjes 05.08.1956, lindur në Zhelizhan, Lushnje dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me ID/pasaportën Nr. Personal F60805065E .

NENI 1 – Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë së luajtshme, 100 % (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë **“ORLU” Sh.p.k., me NUIS L52609403Q**, nga shitësi në favor të blerësit.

NENI 2 – Çmimi

- 2.1. Shitësi ia shet këtë pasuri blerësit kundrejt një çmimi prej 100 000 (njëqind mijë) Lekë;
- 2.2. Çmimi është paguar i plotë në para fizike (CASH), nga blerësi në favor të shitësit dhe ky i fundit deklaron se nuk ka asnjë pretendim.

NENI 3 – Të drejta dhe detyrime të palëve

- 3.1. Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar;
- 3.2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate me të gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ana e këtij të fundit;
- 3.3. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate blerësit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve;
- 3.4. Blerësi ka detyrim të njoftojë brenda pesë ditëve shitësin në rast se të tretë, ngrenë pretendime pronësie mbi pasurinë objekt kontrate.

NENI 4 – Kalimi i pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës, shitësi zhvishet plotësisht nga pronësia mbi pasurinë objekt kontrate dhe ajo i kalon e plotë blerësit.

NENI 5 – Të ndryshme

- 5.1. Palët do të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 5.2. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Kontrata redaktohet në gjuhën shqipe në tre kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

SHITËSI

Di Gjergj Thoma



Bashkëshorti i shitësit

BLERËSI

Kreshnik Sejta
Sejta

Di Gjergj Thoma
Gjergj Thoma